

“Të drejtat e pronësisë në këndvështrimin gjinor”

Më datë 11/05/2017, në Sarandë u zhvillua trajnimi me temë “Të drejtat e pronësisë në këndvështrimin gjinor”, nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) në bashkëpunim me Zyren Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Dhomen Kombëtare të Noterëve dhe Dhomen Kombëtare të Avokatisë, me mbështetjen e Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN WOMEN).

Ky trajnim u organizua nga QNL në kuadrin e zbatimit të projektit “Mbështetje aksesit të grave në të drejtat pronësore përmes rritjes së nivelit të informacionit, këshillimit ligjor dhe ndërgjegjësimit.”

Në trajnim morën pjesë noterë nga Saranda, Gjirokastra, Tepelena, Përmeti, përfaqësues nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme të të gjitha rrethëve të përmendura më sipër, përfaqësues nga zyra qendrore e pasurive të paluajtshme Tiranë, etj.

Interesi i pjesëmarrësve në lidhje me temat e përzgjedhura për diskutim ishte i lartë, duke ndarë me të pranishmit eksperiencat e tyre profesionale, praktike dhe vështirësitë që kanë hasur në zgjidhjen e problematikave përkatëse, kryesisht në aspektin gender.

Ndër diskutimet dhe problematikat kryesore veçojmë: Mbetej problem zbatimi i dispozitës që përcakton **regjistrimin e pasurisë së paluajtshme në emër të të dy bashkëshortëve, kur ajo është fituar gjatë martesës**. Nga diskutimet u evidentuan problematika që kishin të bënin me këtë temë dhe me faktin se ZVRPP-të, veçanërisht nuk e zbatonin prezumimin ligjor të bashkëshortit përfitues të pronësisë, për shkak të keqinterpretimit që i bënin ligjit.

Gjithashtu u kërkua si domosdoshmëri imediate ndërhyrja në aktet ligjore apo ato nënligjore, por edhe akte administrative në mënyrë që të qartësohej procedura e regjistrimit të pronësisë edhe për pjesën e prezumuar të bashkëpronësisë.

Kjo ishte një kërkesë për të cilën ishin dakord të gjithë të pranishmit, duke dhënë edhe sugjerimet e tyre, nisur nga rastet praktike.



Foto nga trajnimi me temë “Të drejtat e pronësisë në këndvështrimin gjinor”, organizuar në Sarandë në datën 11/05/2017.